



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna në lidhje me nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.4.2013, në mbledhjen e mbajtur më **30 korrik 2020**, merr këtë:

### VENDIM PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021 e Komunës së Vushtrrisë.
2. Diskutimi publik fillon nga data 7 gusht 2020 dhe zgjat deri më 7 shtator 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Vushtrrisë që si propozues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin shtator 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit